



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 438/ 2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes se posterit në afërsi të Qendrës së Votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

V E N D I M

REUZOHET si e pabazuara ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR).

A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë më datë 12.12.2010, nga subjekti politik AKR, me të cilën pretendohet se posterit i subjektit politik LDK, është vendosur vetëm 10 metra larg Qendrës së Votimit në Shkollën “Isa Boletini” në fshatin Isniq komuna e Deçanit, që është në kundërshtim me nenin 36 paragrafi 1 pika (a) dhe (b) të LZP-së.

Parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se;

- ankesa është e pabazuar.

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës, se janë bërë shkeljet e theksuara në ankesë janë të pabazuara nga shkakut se nuk janë ofruar dëshmi për të besuar se kanë ndodhur shkelja e tillë nga subjekti politik LDK. PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuar më lartë e po ashtu në pajtim me dispozitat e cituara ligjore, në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 438/2010 më datën 13.12.2010.

